

TREGU I SIGURIMEVE NË SHQIPËRI, SHKALLA E PËRQËNDRIMIT DHE PASOJAT NË EKONOMI

Alqi Naqellari¹

¹Pedagog Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
alqinaqellari@gmail.com

Altin Hoti²

²Zv/Rektor, Universiteti Luarasi, Tiranë
altin.hoti@yahoo.com

Greta Angjeli³

³Pedagog Universitetin Mesdhetar te Shqiperise
gretaangjeli@umsh.edu.al

Abstrakt Tregu i sigurimeve në Shqipëri është një aktivitet relativisht i ri. Ai e ka filluar aktivitetin e tij pas viteve 90 me ish kompaninë shtetërore të sigurimeve INSIG. Kjo kompani ju shërbente bizneseve me disa produkte të detyrueshme dhe jo të detyrueshme për tu blerë. Kjo siguronte mjetet motorike, dëmet nga faktorë madhorë dhe sigurimin e jetës. Pas viti 1992 filluan aktivitetin edhe kompani të tjera të vendit dhe të huaja. Sot ushtrojnë aktivitetin e tyre nëntë kompani të tilla. Vëllimi i punës së tyre është rritur nga rritja e numrit të mjeteve motorike, futja e sigurimit të jetës në fushën e kredive si dhe e disa produkteve të tjera. Kjo reflektohet në dy tregues, i pari është primi i shkruar bruto dhe i dyti pagesa e dëmeve. Rritja e numrit të tyre dhe ndryshimi strukturës ka bërë që të ulet edhe shkalla e përqëndrimit duke kaluar drejt një strukture tregu konkurrencë monopolistike nga monopol që ka qënë në periudhën fillestare. Analiza e përqëndrimit të tregut është realizuar duke përdorur metodat e krahasimit, analizës e sintezës, si dhe një sërë indeksesh CR4, HHI, HTI dhe CCI. Në bazë të këtyre përcaktimeve rekomandohet që AMF¹ -ja të përcaktojë primet e sigurimit të produkteve të detyrueshme. Të përcaktojë primin e mjeteve motorike sipas vjetërsisë, kualifikimit, aksidenteve të bëra etj. Kjo sepse me këtë produkt është abuzuar për vite me rradhë. Këto rekomandime do ti vijnë në ndihmë Autoritetit të Konkurrencës për të mbrojtur subjektet ekonomike nga kufizimi, pengimi dhe shtrëmbërimi i konkurrencës.

Fjalë kyçe: sigurime, konkurrenca, treg përkatës, dominim, treguesit e përqëndrimit të tregut

INSURANCE MARKET IN ALBANIA, THE CONCENTRATION LEVEL AND CONSEQUENCES IN THE ECONOMY

Abstract The insurance market in Albania is relatively a new activity. He has started its activity after the 90s with the former state-owned insurance company INSIG. This company served businesses with some mandatory and non-mandatory products for purchase. This ensured motorized vehicles, damage from major factors and life insurance. After 1992 started the activity some other domestic companies and foreign. Today carry out their activity nine companies like that. The volume of their work is enhanced by the increase of the number of motor vehicles, the introduction of life insurance in the field of credit and some other products. This is reflected in two indicators, the first one is the gross written premium and the second payment of damages. Increasing the number and the structure changes is made to sit by the degree of concentration towards a monopolistic market structure from monopoly to competition that has been in the initial period. Analysis of market concentration is

¹ Autoriteti mbikqyrjes financiare i Republikës Së Shqipërisë

achieved by using the methods of comparison, analysis and synthesis, as well as a series of CR4 index, HHI, HTI and CCI. Based on these definitions is recommended that the AMF to determine insurance premiums of the binding products. To determine motor premium according to their age, qualification, incurred accident etc. This is because with this product has been abused for several years.

These recommendations will help the Competition Authority to protect the economic entities from restriction, obstruction and distortion of competition

Keywords: : *insurance, competition, relevant market dominance, market concentration indices*

1. Hyrje

Tregu i sigurimeve është pjesë e tregut financiar. Ai ka marrë zhvillim mjaftë vonë, për pasojë nuk ka ndonjë histori të gjatë për ta përshkruar. Deri në vitin 1999 ka qënë thujse tërësisht i centralizuar në një kompani me kapital tërësisht shtetëror, që u trashëgua nga sistemi i mëparshëm ekonomik.

Nga viti 1999 deri në vitin 2003, tregu i sigurimeve kaloi nga struktura monopol në strukturën oligopol.

Nga viti 2004 deri në vitin 2014, tregu i sigurimeve kaloi nga struktura oligopol në strukturën e konkurrencës monopolistike. Nga një kompani shtetërore që eksistonte (INSIG) sot në këtë treg veprojnë 9 kompani për sigurimin e jo jetës dhe 3 kompani për sigurimin e jetës (11=8 jo jetë, 2 jetë, 1 e përbashkët). Pavarësisht nga kjo rritje ky treg akoma varet nga sigurimi jo vullnetar dhe përgjithësisht nga sigurimi i mjeteve motorike. Në raport me strukturat e tjera ai nuk zë më shumë se 4% të sistemit financiar. E vlen të theksojmë këtu se sistemi financiar shqiptar bazohet në sistemin bankar si tregu kryesor, në tregun e sigurimeve dhe në tregun e pensioneve. Në Shqipëri nuk ka tregje sekondare. Nuk ekziston institucioni i bursës, për pasojë ekonomia mbështetet tërësisht në sistemin bankar. Në këtë material do të bëhet një përshkrim i dinamikës së këtij tregu duke parë shkallën e përqendrimit të tij. Kjo do të bëhet sepse duke qënë një treg i formës së konkurrencës monopoliste konsiderohet si treg i pastër në kushtet e ekonomisë reale. Kompanitë që veprojnë në treg në disa raste kanë bërë marrëveshje me njëra tjetrën për vendopsjen e çmimeve të njëjta të larta. Kështu, në këtë treg nuk kemi një konkurrencë të nderëshme sepse nëse, teorikisht njëra do ulte çmimin, kjo ulje do shoqërohej nga të gjitha kompanitë e tjera, ndryshe ajo do tu merrte klientët kompanive të tjera. Në këtë treg ka ndodhur e kundërta, njëra ka rritur çmimin dhe të gjitha të tjerat e kanë ndjekur atë. Ky është problemi. Në këtë material janë dhënë mendime sesi duhet të vepohet për të mbrojtur qytetarët nga kjo konkurrencë e panderëshme.

2. Metoda e përdorur

Në këtë material kemi përdorur metodën e përshkrimit, kjo për të pasqyruar dinamikën e tregut të sigurimeve. Kemi përdorur metodën e krahasimit sidhe të analizës dhe sintezës. Arsyet janë të thjeshta sa më shumë analizë aq më shumë konkluzione të sakta do të rezultojnë. Për të pasur një analizë më të thelluar kemi

përdorur edhe një sërë tregues të përqëndrimit si CR4, HHI, HTI dhe CCI. Këta tregues janë përdorur për periudhën 1999-2004 vetëm për dy shërbime ndërsa për periudhën në vijim 2010-2014 janë përdorur për katër tregues.

Si është shkalla e përqëndrimit të primeve bruto, dëmeve në total dhe për mjetet motorike. Shkalla e përqëndrimit të kredive, depozitave dhe fitimit është e lartë. Më poshtë po japim disa nga treguesit kryesorë që pasqyrojnë shkallën e përqëndrimit të tregut të sigurimeve.

Treguesi CR. Formula $CR_k = \sum_{i=1}^k S_i$. Karakteristikat. Përfshin pjesëmarrjen e k bankave më të mëdha të tregut bankar. Kjo është një metodë e thjeshtë dhe kërkon të dhëna pak në krahasim me treguesit e tjerë. Për këtë arsye është një nga më të përdorurit në literaturë (indeksi i veçantë). Shpjegimi. Indeksi i afrohet 0 për një numër të pafund të subjekteve të së njëjtës madhësi dhe i qasjet 1 në qoftë se subjektet më të mëdha përbëjnë të gjithë industrinë. Norma e përqëndrimit luhetet nga 0 deri në 100. Zakonisht për të klasifikuar tregun përdoren këto vlerësime:

Nuk ka përqëndrim . 0% do të thotë konkurrencë e përsosur ose kemi shumë pak konkurrencë monopolistike. Nëse për shembull $CR_4 = 0\%$, firma e madhe e katërt në industri nuk do të ketë ndonjë pjesë të rëndësishme të tregut.

Përqëndrim i plotë. 100% do të thotë një oligopol jashtëzakonisht i koncentruar. Nëse për shembull $CR_1 = 100\%$, kemi një monopol.

Përqëndrim i ulët. 0% deri 50%. Kjo kategori shkon nga konkurrenca e përkryer për të oligopol.

Përqëndrim i mesëm. 50% në 80%. Një industri në këtë varg është e mundshme një oligopol.

Përqëndrim i lartë. 80% deri 100%. Kjo kategori shkon nga oligopol te monopoli.

Herfindahl-Hirschman, HHI. Formula $HHI = \sum_{i=1}^n S_i^2$. Referohet si indeks i informacionit të plotë sepse përfshin informacion të plotë për të tëra subjektet e shpërndarjes. Thekson rëndësinë e subjekteve më të mëdha, duke ponderuar me një vlerë më të lartë njësitë e vogla. Shpjegimi. Indeksi është midis $1/n$ dhe 1 duke arritur në kufij të ulët kur të gjitha subjektet janë në të njëjtën madhësi, dhe kap kufirin e sipërm në rastin e monopolit. Për të klasifikuar tregun përdoren këto vlerësime:

Indeksi HHI poshtë 0.01 (ose poshtë 100) tregon një treg shumë konkurrues.

Indeksi HHI më i vogël se 0.15 (ose 1,500) tregon një treg jo të përqëndruar.

Indeksi HHI midis 0,15-0,25 (ose 1.500 dhe 2.500) tregon një përqëndrim të moderuar.

Indeksi HHI mbi 0.25 (mbi 2500) tregon se kemi një përqëndrim të lartë.

Indeksi HHI është indeksi më i përdorur nga ana e Autoritetit të Konkurrencës për përcaktimin e shkallës së përqendrimit të tregut. Vlera e tij ndryshon nga 0 që tregon konkurrencën perfekte në 10000 që tregon monopolin.

Klasifikimi i tregut sipas Komisioni Evropian dhe përkatësisht nga DOJ+FTC:

Tabela 1 Niveli i indeksit të HHI

Shkalla e përqendrimit	Vlera e HHI	
	Komisioni Europian	DOJ + FTC
I ulët	< 1000	< 1500
Mesatar	1000 – 2000	1500 – 2500
I lartë	> 2000	> 2500

Source: European Commission and DOJ+ FTC

Megjithëse HHI është indeksi më i përdorur nga Autoriteti i Konkurrencës për të matur shkallën e përqendrimit të tregut, rezultatet e tij nuk janë gjithmonë të rëndësishme për tregun e analizuar. Në përgjithësi ky indeks përdoret në tregun e prodhimit të produkteve, të blerjeve apo të shitjeve të tyre. Kjo sepse kur ka vetëm kompani me aksione të vogla të tregut, shfrytëzimi HHI çon në nënvlerësimin e shkallës së përqendrimit të tregut. Prandaj rekomandohet të përdoret edhe Indeksi i Hall-Tideman në rastin e një tregu të tillë. Përsa i përket tregut bankar, si pasojë e veçorive të tij, rekomandohet të përdoret Indeksi Rosse Panzar apo tregues të tjerë që lidhen me këtë sektor të aktivitetit ekonomik. Krahas tyre mund të përdoret indeksi CCI dhe Koeficienti Gini.

Hall-Tideman, HTI. Formula. $HTI = 1 / (2 \sum_{i=1}^n is_i - 1)$. Karakteristikat. Thekson nevojën për të përfshirë numrin e subjekteve që reflektojnë konkurrimin në treg; një numër i vogël i subjekteve që përfaqësojnë kushtet e vështira të hyrjes në industrinë bankare dhe të kundërtën për një numër më të madh të subjekteve. Pjesa e tregut e çdo kompanie është e peshuar me renditjen e saj.

Indeksi tenton 0 për një numër të pafund të subjekteve me madhësi të barabarta, dhe bëhet 1 në rastin e monopolit.

Përqëndrimi industrial, CCI. $CCI = s_i + \sum_{i=2}^n s_i^2 (1 + (1 - s_i))$. Ky tregues kombinon tiparet e indeksit të shpërndarjes relative dhe madhësisë absolute. Na jep shumën e pjesëmarrjes së kompanive me aksionet më të mëdha deri në sheshimin e subjekte të tjera, të ponderuara me koeficientin që pasqyron madhësinë proporcionale të pjesës tjetër të industrisë. Indeksi është 1 në rastin e monopolit dhe është i madh në rastin e pjesëmarrjes së bankave të mëdha në një industri me një numër të madh të subjekteve bankare.

Koeficienti Pearson Formula. $r = \frac{n(\sum xy) - (\sum x)(\sum y)}{\sqrt{[n \sum x^2 - (\sum x)^2][n \sum y^2 - (\sum y)^2]}}$

Numerikisht, koeficienti Pearson përfaqësohet në të njëjtën mënyrë si një koeficient korrelacioni që përdoret në një regresioni linear; duke filluar nga -1 te +1. Vlera +1

është rezultat i një marrëdhënie perfekte pozitive midis dy ose më shumë variablave. Në anën tjetër, një vlerë -1 përfaqëson një marrëdhënie të përsosur negative. Koeficienti Pearson mund të ketë një gabim të vogël, kur ai përdoret me një ekuacion jo-linear.

3. Dinamika dhe struktura e zërave të sigurimeve

1992-1998. Tregu i sigurimeve ka qënë monopol shtetëror.

1999- 2003. Tregu i sigurimeve kalon nga struktura monopol në oligopol.

2004 -2014. Tregu i gigurimeve kalon nga struktura oligopol në konkurrencë monopolistike

Parlamenti shqiptar sfidës së privatizimit të ekonomisë ju përgjigj me miratimin e një sërë ligjeve për sistemin financiar bankar dhe jo bankar. Kështu në këtë kuadër u miratua Ligji 8081, dt 07/03/1996 “Mbi aktivitetin në sigurime dhe/ose risigurime”. Ky ligj bëri që të krijohej një infrastrukturë e nevojëshme ligore për krijimin e dhe zhvillimin e tregut të sigurimeve në Shqipëri. Ky ligj i çeli rrugë inisiativës private për zhvillimin e këtij sektori të tregut financiar jo bankar.

=1992-1998. Tregu i sigurimeve ka qënë monopol shtetëror. Në 31.07.1991 Parlamenti miratoi ligjin për krijimin e INSIG-ut. Deri në vitin 1998 në Shqipëri ka vepruar vetëm një Kompani Sigurimesh me 100% kapital shtetëror. Në vitin 1998 u krijua Komisioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve me misionin e mbikqyrjes së tregut të sigurimeve. Primi i shkruar bruto deri në fund të 1998 ishte rreth 1.5 miliardë lekë.

=1999- 2003. Tregu i sigurimeve kalon nga struktura monopol në oligopol. Kemi një përmirësim të dukshëm të treguesve në favor të konkurrencës. Në 1999 ky institucion(AMF) licensoi kompanitë e para private me kapital 100% shqiptar. Në po këtë vit ju dha autorizimi SIGMA Vienna Insurance Group, SIGAL Uniqa Group Austria. Në 2001 ju dha autorizimi ATLANTIK dhe INTERSIG Vienna Insurance Group. Në këtë periudhë vepronin 5 kompani sigurimi me rreth 54 degë dhe 560 agjentë në të gjithë teritorin e Shqipërisë. Në vitin 2003 niveli i primeve të sigurimit vullnetar kapte 24.18% të totalit të tregut, ai i sigurimit të jetës zinte vetëm 2.2% të tregut. Në këto vite rritja e numrit të mjeteve motorike dhe e kompanive të sigurimit bëri që të dyfishohen primet e sigurimit dhe dëmet e paguara duke e kaluar tregun nga monopol në një strukturë oligopol. Primet e shkruara dhe dëmet në këto vite kanë qënë:

Tabela 2 Primet e shkruara dhe dëmet për vitet 1999-2003 në ml lekë²

	Emërtimi	1999	2000	2001	2002	2003
1	Primet e shkruara bruto të tregut	1,847	2,017	2,967	3,804	3,755
2	Primet e shkruara bruto të jo jetës	1,843	2,009	2,792	3,519	3,669
3	%2/1	99.78	99.60	94.10	92.50	97.70
4	Prim i shkruar bruto sigurimi motorik	1,523	1,599	2,177	2,779	2,998
5	% 4/2	82.63	79.59	77.97	78.97	81.7
6	Dëmet e paguara bruto të tregut	783	710	736	866	1,319
7	Dëmet e paguara bruto për jo jetën	783	710	736	853	1.286
8	% 7/6	100	100	100	98.5	97.49

Në shumë absolute primet e shkruara bruto nga viti 1999 në 2003 janë rritur me 2 herë, të jo jetës me 199%, dëmet e paguara bruto me 68.4% etj. Primet e shkruara bruto të jo jetës nga viti 1999 në vitin 2003 janë ulur shumë pak në përqindje ndaj totalit. Kështu nëse në 1999 ato zinin 99.78% të totalit në vitin 2003 zinin 97.7%. Ndryshimi në 5 vite është fare i vogël, vetëm me 2.08%. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për raportin e primit të shkruar bruto për mjetet motorike ndaj primit të shkruar bruto të jo jetës. Nga 82.6% që zinte në vitin 1999 në 2003 zuri 81.7% ose u ul vetëm me 0.9%. Dëmet e paguara thuajse janë të gjitha për jo jetën. Vetëm në 2002 dhe 2003 kanë filluar pagesat për jetën me 1.5% dhe 2.51%. Nga analiza konkluzioni është i thjeshtë; në këto vite tregu sigurimeve mbështetej në sigurimin e jo jetës dhe ky mbështetej në sigurimin e mjeteve motorike që është një sigurim vullnetar.

Më poshtë do shikojmë shkallën e përqendrimit për këta dy tregues për viteët 1999-2003.

Tabela 3 Ndarja e tregut sipas kompanive për vitet 1999 dhe 2003 në %³

Nr	Emërtimi	Prim i Shkruar Bruto për Shoqëritë e jo Jetës%					Dëmet e paguara Bruto për Shoqëritë e jo Jetës%					
		1999	2000	2001	2002	2003	1999	2000	2001	2002	2003	2004
1	Insig	92.53	70.8	58.21	37.6	23.14	97.72	85.84	71.74	63.31	50.73	31.51
2	Sigma	5.9	14.92	17.63	23.46	28.89	2.12	9.90	16.98	17.66	18.37	30.67
3	Sigal	1.57	14.28	21.81	27.65	30.00	0.16	4.27	10.88	15.12	23.42	25.76
4	Atlank	-	-	2.02	6.02	8.39	0	0	0.35	1.60	2.29	6.42
5	Intersig	-	-	0.34	5.27	9.58	0	0	0.04	2.32	5.20	5.63
	CR₂	98.4	85.7	80	65.2	58.8	99.8	95.8	88.5	81	69	61
	HHI	8599.1	5439.2	4179.1	2792.7	2432.3	9553.7	7484.7	5553.4	4551.2	3464.7	2638.3
	HTI	0.847	0.535	0.437	0.305	0.267	0.9535	0.7305	0.5574	0.4494	0.3706	0.2874
	CCI	0.927	0.787	0.724	0.617	0.568	0.9781	0.8806	0.7923	0.7338	0.6717	0.6041

Nga të dhënat e tabelës shihet se numri i kompanive nga viti 1999 në vitin 2003 është rritur nga 3 në 5. Përveç rritjes së numrit kemi edhe ndryshimin e përqindjes së tregut prej tyre. Këtë e kemi pasqyruar edhe në grafikët e mëposhtëm(1 dhe 2) për vitet 1999 dhe 2003 për primin e shkruar bruto.

² Tregu i sigurimeve raport statistikor '99-09'. Autoriteti Mbikqyrjes Financiare.2010

³ Tregu i sigurimeve raport statistikor '99-09'. Autoriteti Mbikqyrjes Financiare.2010




Figura 1 Ndarja e tregut për primin e shkruar bruto për vitet 1999 dhe 2003




Figura 2 Ndarja e tregut për primin e shkruar bruto për vitet 1999 dhe 2003

Sa i përket strukturës së dëmeve të paguara bruto nuk ka nevojë për ta paraqitur sepse shifrat flasin që kemi thjesht të njëjtat raporte.

Nga analiza e treguesve të përqëndrimit konkludohet se tregu ka kaluar nga monopol në oligopol. Për këtë shikojmë me rradhë madhësinë e koeficientëve.

= CR_2 nga 92.53% (monopol) në vitin 1999 ka kaluar në 58.8% në vitin 2003. Përqëndrim të mesëm kemi kur CR varjon nga 50-80%. Kjo i takon konkurrencës *oligopol*.

= HHI, nga 8599(monopol) në vitin 1999 ka kaluar në 2432 në vitin 2003. Indeksi midis 1500(0.15) dhe 2500(0.25) paraqet një përqëndrim të moderuar. I takon *oligopolit*.

= HTI, nga 0.847(monopol) në vitin 1999 ka kaluar në 0.267 në vitin 2003. Indeksi 0.267 tregon për një treg të moderuar. Përgjithësisht i takon *oligopolit*.

= CCI, nga 0.927(monopol) në vitin 1999 ka kaluar në 0.568 në vitin 2003. Ky indeks tregon se kemi një treg të moderuar që i takon *oligopolit*.

= **2004 -2014. Tregu i gigurimeve kalon nga struktura oligopol në konkurrencë monopolistike.** kemi dyfishim të numrit të kompanive të licensuara që veprojnë në treg. Në 2004 ju dha autorizimi kompanive; ALBSIG, EUROSIG, INTERALBANIAN Vienna Insurance Group. Në këtë vit ju dha autorizimi për sigurimin e jetës kompanive SiCRED(sigurim jete), SIGAL-LIFE Uniqa Group

Austria(sigurim jete). Në vitin 2012 ju dha autorizimi kompanisë ANSIG. Kështu sot kemi 9 kompani të sigurimit të jo jetës(11=8,2,1). Në tregun e sigurimeve, u futën edhe partner të huaj si BERZH dhe IFC ishin partner të INSIG-sha , Vjena Insurance Group-partnesr i Sigma-sha, i Interalbaniian – sha dhe INtersig-sha, Uniqa Group- partner i Sigal-sha. Duke përjashtuar INSIG që ka 100% kapital shtetëror, të gjitha kompanitë e tjera janë me kapital privat.

Tabela 4 Primet e shkruara dhe dëmet për vitet 2004-2009 në ml lekë⁴

	Emërtimi	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2009/2004 në %
1	Primet e shkruara bruto të tregut	4,151	4,011	4,542	5,948	7,076	7,877	89.7
2	Primet e shkruara bruto të jo jetës	4,037	3,772	4,201	5,517	6,530	7,084	75.6
3	%2/1	97.25	94.04	92.5	92.75	92.28	89.93	x
4	Prim i shkruar bruto sigurimi motorik	3,144	2,827	3,237	4,240	4,493	4,771	51.7
5	% 4/2	77.87	74.94	77.05	76.85	68.8	67.34	x
6	Dëmet e paguara bruto të tregut	1,038	1,227	1,287	1,294	1,571	1,733	67.1
7	Dëmet e paguara bruto për jo jetën	1,031	1,212	1,275	1,250	1,256	1,654	60.4
8	% 7/6	99.4	98.77	99	96.59	79.9	95.44	x

Në shumë absolute primet e shkruara bruto nga viti 2004 në vitin 2009 janë rritur me 89.7%, të jo jetës me 75.6%, dëmet e paguara bruto me 67.1% etj. Primet e shkruara bruto të jo jetës nga viti 2004 në vitin 2009 janë ulur në përqindje ndaj totalit. Kështu nëse në 2004 ato zinin 97.25% të totalit në vitin 2009 zinin 89.93%. Ndryshimi në 6 vite është i konsiderueshëm me 7.31%. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për raportin e primit të shkruar bruto për mjetet motorike ndaj primit të shkruar bruto të jo jetës. Nga 77.87% që zinte në vitin 2004 në 2009 zuri 67.34% ose u ul me 10.53%. Dëmet e paguara kanë rënë për jo jetën. Nga 99.4% në 2004 në 95.44% në vitin 2009. Nga analiza konkluzioni është i thjeshtë; në këto vite tregu sigurimeve mbështetej në sigurimin e jo jetës dhe ky mbështetej në sigurimin e mjeteve motorike që është një sigurim vullnetar pavarësisht se në krahasim me vitet 1999-2004 ka një rënje të tij.

Tabela 5 Ndarja e tregut sipas kompanive për vitet 2004 dhe 2009 në %⁵

		Primi shkruar bruto për shoqëritë e jetës në %						Dëmet e paguara bruto në % për shoqëritë e jetës				
		2004	2005	2006	2007	2008	2009	2005	2006	2007	2008	2009
1	Insig	16.8	16.0	18.5	16.3	15.2	12.5	22.0	17.2	12.8	20.5	13.7
		1	4	9	5	3	1	5	7	9	5	4
2	Sigma	26.8	20.1	18.5	17.8	15.5	14.7	32.6	33.0	31.5	20.3	18.6
		9	8	4	2	7	5	9	4	1	2	3
3	Sigal	30.9	28.9	27.3	27.5	26.6	29.7	24.1	25.0	28.5	28.2	33.5
		7	3	3	9	3	2	8	8	8	7	0
4	Atlank	13.8	10.9	11.3	12.7	11.6	10.2	7.35	8.15	10.4	12.5	8.2

⁴ Po aty

⁵ Po aty

		7	3	6	2	1	0			7	4	
5	Intersig	9.90	9.66	7.98	5.55	7.68	8.70	10.26	8.2	4.98	3.32	7.1
6	Eurosig	0.26	2.28	3.21	5.18	4.56	5.49	0.41	1.33	2.05	2.26	2.47
7	Interalb an	0.75	6.66	7.03	7.94	10.67	11.32	1.44	4.45	5.8	8.74	11.41
8	Albsig	0.55	5.31	5.95	6.87	8.05	7.30	1.61	2.48	3.72	4.00	4.95
	CR₂	57.8	49.1	45.9	45.4	42.2	44.4	56.9	58.1	60.1	48.8	52.1
	CR₄	74.7	65.1	64.4	61.7	57.4	56.9	78.9	73.4	73.0	69.1	65.9
	HHI	0.2493	0.1962	0.1887	0.1822	0.1714	0.1723	2304	2180	2162	1900	1937
	HTI	0.2493	0.1962	0.1887	0.1822	0.1714	0.1723	0.2525	0.2345	0.2267	0.2088	0.2036
	CCI	0.7034	0.6085	0.5823	0.5768	0.5516	0.5918	0.7321	0.7083	0.6892	0.6203	0.6731

Nga të dhënat shihet se numri i firmaver është rritur nga 5 në 8. Rritja e numrit të tyre ka bërë që të ulet edhe pjesa e tregut për firmat ekzistuese. Ky ndryshim është pasqyruar edhe në grafikët e mëposhtëm(3 dhe 4).




Figura 1 Ndarja e tregut për primin e shkruar bruto për vitet 2004 dhe 2009




Figura 2 Ndarja e tregut për primin e shkruar bruto për vitet 2004 dhe 2009

Nga analiza e treguesve të përqëndrimit konkludohet se tregu ka tendencë të kalimit nga oligopol në konkurrencë monopolistike. Për këtë shikojmë me rradhë madhësinë e koeficientëve.

= CR₂ nga 57.8% (olig) në vitin 2004 ka kaluar në 44.4% në vitin 2009. Përqëndrim i ulët kemi kur CR varjon nga 0-50%. Kjo i takon konkurrencës *konkurrencë monopolistike*.

= CR₄, nga 74.7% ka kaluar në 56.9%.

= HHI, nga 0.249(oligopol) në vitin 2004 ka kaluar në 0.172 në vitin 2009. Indeksi midis 0.15-0.25 paraqet një përqëndrim të moderuar. Afrohet më shumë me konkurrencën monopolistike(nën 0.15 ose 1500) me tendencë oligopolin.

= HTI, nga 0.249(oligopol) në vitin 2004 ka kaluar në 0.172 në vitin 2009. Indeksi 0.172 tregon për një treg të moderuar. Përgjithësisht i takon *konkurrencës monopolistike me tendencë oligopolin*

= CCI, nga 0.703(monopol) në vitin 2004 ka kaluar në 0.592 në vitin 209. Ky indeks tregon se kemi një treg të moderuar që i takon *oligopolit* me tendencë konkurrencë monopolistike.

Konkluzioni është se tregu po kalon nga konkurrenca oligopolistike në konkurrencë monopolistike.

Në 2006, në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, u krijua Autoriteti i Mbikqyrjes financiare që do vepronte në sektorin e sigurimeve, të pensioneve private dhe atë të letrave me vlerë. AMF është person juridik publik dhe ushtron aktivitetin në përputhje me dispozitat në fuqi. AMF licenson, mbikqyr veprimtarinë e sigurimit, risigurimit, të ndërmjetësimit dhe të operacionit që rrjedhin drejtpërdrejtëq nga këto veprimtari, lidh kontrata, marrëveshje, nxjerr akte normative dhe rregulluese që lidhen me tregun e sigurimeve. Më poshtë do analizojmë periudhën 2010-2013.

Tabela 6 Primet e shkruara dhe dëmet për vitet 2010-2013 në ml lekë⁶

Nr	Emërimi	2010	2011	2012	2013	013/010
1	Primet e shkruara bruto të tregut	8,200	8,215	8,950	8,538	104.1
2	Primet e shkruara bruto të jo jetës	7,303	7,256	8,042	7,524	103.0
3	%2/1	89.1	88.3	89.9	88.1	
4	Prim i shkruar bruto sigurimi motorik	4,840	4,354	5,120	4,383	90.6
5	% 4/2	66.3	60.0	63.7	58.3	
6	Dëmet e paguara bruto të tregut	2,299	2,228	2,808	2,696	117.3
7	Dëmet e paguara bruto për jo jetën	1,925	1,723	2,117	2,197	114.1
8	% 7/6	83.7	77.3	75.4	81.5	

Nga të dhënat shihet se primet e shkruara bruto janë rritur me 4.1%, ndërsa primet e shkruara bruto të jo jetës me vetëm 3%. Prim ii shkruar bruto për sigurimin motorik ka rënë në 90% të 2010. Janë rritur pagesat e dëmeve në total me 17.3% dhe për jo jetën me 14.1%. Të dhënat tregojnë se primet dhe dëmet per jetën kanë ardhur në rritje në krahasim me primet dhe dëmet për jo jetën. Primet e shkruara bruto të jo

⁶ Po aty

jetës ndaj totalit kanë rënë vetëm me 1% në 2013 në krahasim me vitin 2010. Po kështu kanë rënë orimet e shkruara bruto për mjetet motorike në krahasim me primet e shkruara bruto të jo jetës. Në 2013 zinin vetëm 58.3% të tyre. Ky është një tregues pozitiv sepse tregon se po rritet pesha e produkteve të tjera në raport me mjetet motorike.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-prill 2014 arritën rreth 3,505 milionë lekë, ose 26.01% më shumë se në periudhën janar-prill 2013, thekson Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Gjatë periudhës janar-prill 2014, sipas AMF-së, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 281,345, me një ulje prej 8.79% krahasuar me janar-prillin e një viti më parë. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar te sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën rreth 89.56% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me rreth 9.77% dhe veprimtarinë e Risigurimit me rreth 0.66%.

Tabela 7 Ndarja e tregut në total sipas kompanive 2010-2014 në %⁷

Emërtimi	Primi shkruar bruto në% ndaj totalit					Dëme të paguara në % ndaj totalit				
	2010	2011	2012 ⁸	2013 ⁹	2014 ¹⁰	2010	2011	2012	2013	2014
Sigal U. G. A	30.71	32.85	30.33	34.52	28.42	28.53	32.07	31.59	31.76	24.20
Intersig V. I. G	9.86	9.46	9.18	10.85	13.15	11.26	13.36	10.45	8.06	14.18
Eurosig	6.28	8.44	10.07	12.72	11.82	15.96	11.70	10.31	14.30	13.25
Sigma V. I. G	15.39	13.27	11.87	8.95	10.31	6.38	8.44	20.29	9.44	12.80
Albsig	7.44	7.98	8.62	8.31	10.09	13.78	7.13	4.47	9.84	10.56
Interalbanian V. I. G	11.09	10.10	11.86	9.05	7.92	4.38	5.61	4.65	6.88	8.32
Insig	8.41	8.13	7.54	5.24	6.96	14.60	15.10	11.82	9.75	8.31
Atlantik	10.83	9.77	8.29	5.12	5.94	5.10	6.59	6.28	8.15	4.19
Ansigt	0	0	2.23	5.24	5.38	0	0	0.13	1.82	4.18
CR4	65.33	64.02	58.04	53.83	51.63	72.88	72.23	74.15	65.65	64.43
HHI	1683	1743	1592	1783	1504	1685	1769	1846	1676	1411
HTI	0.172	0.168	0.158	0.167	0.154	0.182	0.181	0.193	0.165	0.153
	3	1	2	8	3	0	7	6	1	6
CCI	0.446	0.455	0.43	0.457	0.416	0.447	0.46	0.473	0.444	0.397

Nga të dhënat shihet se në këto vite është shtuar edhe një kompani tjetër në treg ANSIG. Kjo ka bërë që të vazhdojë zvogëlimi i pjesëve të tregut për kompanitë

⁷ Raporti vjetor 2013.AMF Albania.2014

⁸ Po aty

⁹ Buletini statistikor tregu i sigurimeve viti 2013. 2014. [Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për vitin 2013](#). Botuar më22/01/2014

¹⁰ [Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2014](#). Botuar më25/09/2014.

ekzistuese. Më poshtë kemi paraqitur grafikisht strukturën e tregut sipas kompanive për katër tregues.




Figura 5 Ndarja e tregut për primin e shkruar bruto për vitet 2010 dhe 2014




Figura 6 Ndarja e tregut për primin e shkruar bruto për vitet 2010 dhe 2014

Nga analiza e treguesve të përqëndrimit konkludohet se tregu ka tendencë të kalimit nga oligopol në konkurrencë monopolistike. Për këtë shikojmë me rradhë madhësinë e koeficientëve.

= CR_2 nga 47.1% (oligopol-km) në vitin 2010 ka kaluar në 41.57% në vitin 2014. Përqëndrim i ulët kemi kur CR varjon nga 0-50%. Kjo i takon konkurrencës *konkurrencë monopolistike*.

= CR_3 , nga 57.19% ka kaluar në 53.39%. Ky tregues tenton 50 që shpreh konkurrencën monopolistike.

= CR_4 , nga 63.3% në 51.63%.

= HHI, nga 0.1683(oligopol) në vitin 2010 ka kaluar në 0.1504 në vitin 2014. Indeksi midis 0.15-0.25 paraqet një përqëndrim të moderuar. Afrohet më shumë me konkurrencën monopolistike(nën 0.15 ose 1500) me tendencë oligopolin.

= HTI, nga 0.1723(oligopol) në vitin 2010 ka kaluar në 0.154 në vitin 2014. Indeksi 0.154 tregon për një treg të moderuar. Përgjithësisht i takon *konkurrencës monopolistike*.

= CCI, nga 0.446(oligopol) në vitin 2010 ka kaluar në 0.416 në vitin 2014. Ky indeks tregon se kemi një treg të moderuar që i takon *oligopolit* me tendencë konkurrencë monopolistike.

Konkluzioni është se tregu ka kaluar nga konkurrenca oligopolistike në konkurrencë monopolistike. Më poshtë kemi dhënë edhe treguesit për mjetet motorike.

Tabela 8 Ndarja e tregut për mjetet motorike sipas kompanive 2010-2014 në %¹¹

Emërtimi	Pr.br. për Sig. Motorike në % ndaj totalit					Pag. e dëmeve për Sig. Mot. % ndaj totalit				
	2010	2011	2012 ¹²	2013 ¹³	2014 ¹⁴	2010	2011	2012	2013	2014
Sigal U. G. A	25.62	27.13	24.44	23.17	22.25	26.75	28.82	29.65	24.76	17.46
Intersig V. I. G	6.84	8.09	11.41	16.68	13.55	4.43	6.70	5.18	7.68	15.12
Eurosig	12.53	12.87	12.54	13.42	13.40	6.16	9.09	17.26	10.66	14.45
Sigma V. I. G	14.39	13.08	11.57	9.03	11.92	17.26	11.70	11.84	16.17	13.04
Albsig	8.67	9.41	9.85	9.22	8.91	5.62	7.61	7.40	7.41	12.06
Interalbanian V. I. G	7.05	6.56	7.41	6.14	8.07	12.81	12.03	10.72	11.34	9.51
Insig	11.91	10.21	9.73	8.22	7.99	11.57	15.53	12.33	8.41	9.07
Atlantik	12.99	12.65	10.21	6.82	7.31	15.39	8.52	5.45	11.56	4.72
Ansig	0	0	2.84	7.29	6.58	0	0	0.16	1.99	4.59
CR4	65.54	65.72	59.96	62.49	61.13	72.21	68.08	71.08	63.84	59.07
HHI	1503	1534	1378	1367	1306	1638	1611	1696	1439	1273
HTI	0.161 8	0.161 7	0.145 8	0.147 5	0.141 3	0.1796	0.1688	0.1801	0.1553	0.1416
CCI	0.415	0.421	0.391	0.401 9	0.376	0.439	0.435	0.449	0.403	0.356

= CR₂ nga 40.01% (konkurrencë monopolistike) në vitin 2010 ka kaluar në 35.8% në vitin 2014. Përqëndrim i ulët kemi kur CR varjon nga 0-50%. Kjo i takon konkurrencës *konkurrencë monopolistike*.

= CR₃, nga 53% ka kaluar në 49.2%. Ky tregues tenton 50 që shpreh konkurrencën monopolistike.

= CR₄, nga 65.54% në 61.13%

¹¹ Raporti vjetor 2013.AMF Albania.2014

¹² Po aty

¹³ Buletini statistikor Tregu i Sigurimeve viti 2013. 2014. [Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për vitin 2013](#). Botuar më22/01/2014

¹⁴ [Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2014](#). Botuar më25/09/2014.

= HHI, nga 0.1503(oligopol-km) në vitin 2010 ka kaluar në 0.1306 në vitin 2014. Indeksi nën 0.15 tregon për një treg jo të përqëndruar, konkurrencë monopolistike.

= HTI, nga 0.1618(oligopol-km) në vitin 2010 ka kaluar në 0.1413 në vitin 2014. Indeksi 0.1413 tregon për një treg të moderuar. Përgjithësisht i takon konkurrencës monopolistike.

= CCI, nga 0.415(oligopol) në vitin 2010 ka kaluar në 0.376 në vitin 2014. Ky indeks tregon se kemi një treg të moderuar që i takon konkurrencë monopolistike.

Konkluzioni është i thjeshtë; struktura e tregut i afrohet konkurrencës monopolistike më shumë sesa oligopolit.

Më poshtë do shikojmë edhe disa tregues të korelacionit(Pearson) midis koeficientëve të llogaritur.

Tabela 9 Koeficientët mesatarë sipas viteve dhe Shkalla e lidhjes midis koeficientëve mesatarë

	CR4	HHI	HTI	CCI		CR4	HHI	HTI	CCI
2010	68.99	1626.9	0.174	0.437	CR4	0	0.871	0.975	0.863
2011	67.51	1664.4	0.170	0.443	HHI	0.871	0	0.941	0.999
2012	65.81	1627.9	0.169	0.436	HTI	0.975	0.941	0	0.936
2013	61.45	1566.4	0.159	0.426	CCI	0.863	0.999	0.936	0
2014	59.07	1373.5	0.148	0.386					

Të dhënat e Tabelës Nr.8 tregojnë se të gjithë koeficientët e përqëndrimit kanë ardhur në rënje duke kapur shkallën e përqëndrimit të konkurrencës monopolistike. Pjesa e djathtë e tabelës na jep lidhjet midis koeficientëve sintetikë të llogaritur me formulën e Pearsonit. Shkalla e lidhjes së tyre është shumë e fortë, gjë që do të thotë se të gjithë koeficientët e përqëndrimit kanë të njëjtat tendenca në lidhje me strukturën e tregut. Të gjithë tregojnë se tregu ka kaluar në një strukturë të konkurrencës monopolistike.

Primi mesatar i sigurimit për mjetet motorike për vitet 2011-2012 dhe 2013 është paraqitur në figurën Nr.5.




Figura 7 Primi i shkruar bruto në euro për vitet 2011-2014

Nga të dhënat u pa se tregu i sigurimeve është liberalizuar në vitin 1999. Që nga ai vit është rritur dukshëm me ndryshime sasiore dhe cilësore, ndryshimi mentaliteti dhe botkuptimi. Megjithëse në këto vite është dyfishuar në krahasim me vendet e rajonit është 10 herë më i vogël për pagesat për frymë. Në 2013 shqiptarët paguanin vetëm 18 euro për frymë. Në përgjithësi ai mbetet më shumë treg i sigurimit të mjeteve motorike i cili është mbështetur në ligjin për sigurimin e detyrueshëm të të këtyre mjeteve, që është i detyrueshëm në të gjithë botën dhe ka si qëllim mbrojtjen e interesave financiare të përdoruesit të mjetit motorik nga dëmet që mund ti shkaktojë një tjetër. Sot në treg ka 11(8,2,1) kompani sigurimesh që ofrojnë shërbime të ndryshme sigurimi. Shqiptarët janë të pa përgatitur për të marrë sigurime. Sot të gjitha ngjarjet e ndodhura në tokë dhe në det, djegjet, shpërthimet e bombolave të gazit, përmytjet, aksidentet, shembjet e dherave dhe reziqet e mëdha që kanë psuar fshatra e godina në qytete, të gjitha llojet e aksidenteve dhe shumë ngjarje të tjera janë të pa mbuluara financiarisht¹⁵. Kjo situatë kërkon zhvillimin e kulturës dhe të legjislacionit për sigurimet. Ndërtimi i një strategjie për sigurimet për mbrojtjen financiare të interesave të qytetarëve është detyrë e ANF-së.

Tregu për sigurimin e detyrueshëm motorik ka pësuar luhatje të herëpashershme në harkun kohor të një viti. Kompanitë e sigurimeve rritën në mënyrë të menjëhershme dhe të njëkohëshme në fillim të muajit shkurt tarifat e sigurimit të detyrueshëm motorik, TPL me rreth 30%. Nga 14,600 lekë që ishte çmimi i TPL-së për autoveturat në fund të muajit janar në mesin e muajit shkurt shkoi në 18,900 lekë¹⁶ Kjo ishte një “manovër” që e kishin parashikuar deri diku kompanitë që operojnë në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, duke qenë se 2013-a u mbyll me performancë negative (-6%). Për vitin 2013, primet e shkura bruto të TPL-së u ulën me rreth 18.6%. Edhe gjatë vitit të kaluar tarifat e TPL-së, pësuan luhatje të forta, duke u shitur shpesh edhe në nivele poshtë primit të rrezikut të përcaktuar nga AMF. Pas rritjes së ndjeshme të tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik, TPL me rreth 30%, në mënyrë të koordinuar nga të gjitha shoqëritë e sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sqaroi se nuk ka kompetencë të ndërhyjë në politikat e tarifimit të shoqërive të sigurimit. Sipas AMF-së, ecuria e çmimeve pas momentit të liberalizimit është karakterizuar nga luhatje në rritje ose në rënie, gjë që është e natyrshme dhe e pritshme për një treg të liberalizuar. Po ashtu, përvojat e vendeve të tjera e konfirmojnë sjelljen e vërejtur në Shqipëri, sidomos në vitet e para pas liberalizimit. Kjo tregon që tregut i duhet një periudhë kohe të përshtatet me kushtet e reja të vlerësimit të riskut dhe përcaktimit të çmimit të tij.

4. Konkluzione dhe Rekomandime

Tregu i sigurimeve në Shqipëri sipas të gjithë koeficientëve të llogaritur të përqëndrimit ka qënë monopol deri në vitin 1998. Nga 1998 deri në 2003 ka kaluar

¹⁵ Avni Ponari.”tregu i sigurimeve si ka ndryshuar pas 14 vjetësh”. Panorama, 22 shkurt 2013.

¹⁶ TIRANE 26 Shkurt/ATSH/2014.

në oligopol dhe sot ai është një treg i konkurrencës monopolistike. Ky treg është një treg normal sepse konkurrencë monopolistike në ekonominë reale do të thotë konkurrencë e pastër. Fenomenet që kanë ndodhur në këtë treg sa u përket primeve të sigurimit të mjeteve motorike kanë folur jo për tendenca të prirjeve teorike por për të kundërtën, kanë folur për marrëveshje të fshehta midis kompanive për rritjen e primeve në kuriz të subjekteve siguruese. Në këtë mënyrë në vend që të kishim një treg konkures kemi një treg me konkurrencë të shtrëmbëruar i cili rëndon buxhetin e subjekteve të ndryshme ekonomike siguruese.

Rekomandojmë që primet e sigurimit të përcaktohen për çdo person që drejton një mjet motorik në bazë të eksperiencës në drejtim të automjetit, moshës së automjetit, moshës së personit, gjinisë së personit, profesionit të personit, dëmeve të shkaktuara nga personi dhe gjendjes shëndetësore të personit. Parlamenti shqiptar ti japi kompetencë AMF-së të ketë të drejtën të vendosi një prim tavan për mjetet motorike dhe për sigurimet jo vullnetare në përgjithësi. Këtë kufi tavan të mos ta përcaktojnë vetë kompanitë. Autoriteti Konkurrencës meqënëse AMF-ja nuk ka kompetenca të ndërhyjë në përcaktimin e tarifave të sigurimeve të ndëshkojë këto kompani për vendosjen e çmimeve të njëjta në të njëjtën kohë, e para dhe e dyta për grafikimin e punës sipas kompanive, veçanërisht në pikat doganore. Konkluzionet që janë nxjerrë në material do ti vijnë në ndihmë këtij institucioni në realizimin e punës së tij.

Bibliografi

1. AMF Albania. Raporti Vjetor 2013. Botuar në 2014. Tiranë
2. AMF Albania. Buletini Statistikor Tregu i Sigurimeve Viti 2013. Botuar në 2014. Tiranë
3. Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për vitin 2013. Botuar më 22/01/2014. Tiranë
4. AMF ALBANIA. Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2014. Botuar më 25/09/2014. Tiranë
5. AMF Albania. Tregu i Sigurimeve raport statistikor '99-09'. 2010. Tiranë
6. AMF Albania. Informacion për Shoqëritë e Sigurimit. 2013. Tiranë
7. AMF Albania. Buletini Statistikor Tregu i Sigurimeve Janar-Maj 2014. Publikuar 25/06/2014. Tiranë
8. AMF Albania. Gjeografia e Tregut të Sigurimeve Raport Statistikor Dhjetor 2013. (Vjetor) (XLS) Tiranë
9. AMF Albania. Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për vitin 2012. Botuar më 25/01/2013. Tiranë
10. AMF Albania. Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për vitin 2011. Botuar më 25/01/2012. Tiranë